



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 3 datë 30/01/1998

**PER
FINANCIMIN NGA TE ARDHURAT E BASHKISE PER
BLERJE USHQIMESH PER CERDHET E FEMIJEVE.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit për financimin nga të ardhurat e Bashkisë për blerje ushqimesh për çerdhet e fëmijëve, në mbështetje të nenit.14 të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” dhe ligjit Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal”,

V E N D O S I

1. Dhënien e fondit nga të ardhurat e Bashkisë Drejtorisë së Qendrës Ekonomike të Çerdheve për blerje ushqimesh me një vlerë 4.000.000 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Qendrës Ekonomike të Çerdheve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

ORHAN SAKIQI